



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. <u>DPK</u>	Nr. Prot. <u>03-02/4841/16</u>
Dep. <u>DPK</u>	Br. Prot. <u>03-02/4841/16</u>
Nr. l faq.	Prot No. <u>03-02/4841/16</u>
Broj stranica <u>03</u>	Data <u>21.12.2016</u>
Nr. pages	Date <u>21.12.2016</u>
PRISHTINË	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 21.12.2016, mori:

**V E N D I M**

**I, Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4374/16, për zyrtarin e lartë z., Astrit Salihu, Këshilltar politik i Presidentit të Republikës së Kosovës, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë ekzistimin e konfliktit të interesit, apo mos pajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.1 dhe 18.2 të Ligjit nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.**

Pas informatës se pranuar nga një palë tretë lidhur me situatën e mundshme të konfliktit të interesit për zyrtarin e lartë z. Astrit Salihu, Këshilltar Politik i Presidentit të Republikës së Kosovës, i cili siç thuhet në informatën e dërguar merr honorarë nga Radio Televizioni i Kosovës (RTK) të cilën e ka deklaruar edhe në formularin e deklaramit të pasurisë.

Pas vlerësimit të kësaj informate është nxjerr vendimi me nr. AKK-03-02-4374/16 për fillimin e shqyrtimit të situatës së mundshme të konfliktit të interesit për zyrtarin e lartë z. Astrit Salihu, Këshilltar Politik i Presidentit të Republikës së Kosovës.

Duke vepruar sipas kompetencave dhe mandatit që kemi, Agjencia kundër Korrupsionit ka zhvilluar procedurën e paraparë duke njoftuar zyrtarin e lartë për fillimin e procedurës për trajtim të situatës së mundshme të konfliktit të interesit.



AKK, ka zhvilluar një takim informues me zyrtarin e lartë për të marrë informata shtesë dhe për ta informuar lidhur me çështjen ngritur për situatë të mundshme të konfliktit të interesit, në takim kanë marrë pjesë dy zyrtar nga AKK-ja dhe zyrtari i lartë z. Salihu.

Gjatë takimit me z. Astrit Salihu, Këshilltar Politik i Presidentit të Republikës së Kosovës, zyrtarët e AKK-së kanë kërkuar nga ai që ti informoj me gjerësisht lidhur me çështjen e ngritur për të, pra konkretisht për pagesën e honorarëve nga RTK-ja, apo angazhimin tij eventual në këtë institucion.

z. Salihu, i ka njoftuar zyrtarët e AKK-së se ai është anëtar i Shoqatës së Filozofeve të Kosovës (SHFK), kjo shoqatë në vitin 2015 ka nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi me Radio Televizionin e Kosovës, këtë memorandum e kanë nënshkruar Drejtori i RTK-së, dhe Kryetarja e Shoqatës së Filozofeve të Kosovës znj. Hasnije Ilazi.

Qëllimi i memorandumit është mbështetja (Përcjellja) e Aktiviteteve të Shoqatës së Filozofeve të Kosovës (SHFK) dhe angazhimi i anëtareve të saj në projekte të Radio Televizionit të Kosovës. Ky memorandum është lidhur duke u bazuar në Ligjin e RTK-së nr.04/L-46, Ligjin për të Drejtat e Autorit Dhe Te Drejtat e Përafërta nr.04/L-065, si dhe ligjet tjera të aplikueshme në Kosovë.

Sipas këtij Memorandumi palët e përfshira pra RTK-ja dhe Shoqata Filozofeve të Kosovës kanë obligime të ndërsjella, RTK-ja do të përcjell të gjitha aktivitetet e SHFK-së duke përfshirë: debatet e hapura, konferencat, seminarët dhe të gjitha aktivitetet tjera me karakter filozofik, kulturor e shkencor, RTK angazhon anëtarët e SHFK-së në projekte brenda RTK-së, RTK, në marrëveshje me SHFK-në, çdo vit ju krijon hapësirë studiuësve të filozofisë të kryejnë praktiken.

RTK, do të angazhojë anëtarët e SHFK-së varësisht nga nevojat brenda projekteve të RTK-së (emisione, debate, etj.)

SHFK (Shoqata e Filozofeve të Kosovës), obligohet që Radio Televizionit të Kosovës (RTK), t'ia dorëzojë listën e anëtareve (studiuësve) që janë të gatshëm për angazhim dhe që i kanë plotësuar kushtet dhe procedurat e parapara nga shoqata.

Shoqata e Filozofeve të Kosovës në kuadër të këtij memorandumit me RTK-në ka krijuar emisionin "Filozofema" emision edukativ i lansuar në RTK në janarin e vitit 2016.

Ky emision trajton tema nga aspekti filozofik, kulturor dhe shkencor, ashtu siç i parasheh statuti i Shoqatës së Filozofeve të Kosovës dhe në harmoni të plotë me memorandumit e bashkëpunimit me RTK-në.

z. Salihu na ka sqaruar se në kuadër të këtij emisioni i cili trajton tema nga aspekti filozofik, kulturor dhe shkencor është i angazhuar në cilësinë e autorit të emisionit "Filozofema" bashkërisht edhe me disa nga anëtarët tjerë të Shoqatës së Filozofeve të Kosovës të cilët po ashtu janë angazhuar në realizimin e këtij emisioni si bashkëpunim me RTK-së dhe Shoqatës së Filozofeve të Kosovës për të cilin angazhim paguhet me honorar apo për secilin emision që realizohet.

Ligji nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik nuk ka parapa dispozita të veçanta që e ndalojnë apo e kufizojnë ushtrimin e funksionit publik si Këshilltar Politik i Presidentit dhe angazhimin eventual në cilësinë e autorit të një emisioni, me karakter filozofik, kulturor dhe shkencor. Ky ligj tek neni 10.2 ndër të tjera ka përcaktuar që një zyrtar i lartë gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik mundë të ushtroj punë nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtarive humanitare nëse nuk parashihet ndryshe me



ligje tjera, po ashtu neni 10.3 i këtij ligji ka përcaktuar se zyrtari i lartë gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik mund të realizoj fitime në bazë të drejtave të Autorit, patentat dhe të drejtave të ngjashme.

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik nr.04/L-051, ka për qëllim të parandalojë konfliktin e interesit të zyrtarët e lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Pas shqyrtimit të fakteve të ofruar nga zyrtari i lartë z. Astrit Salihu, si dhe pas vlerësimit të dokumenteve përcjellëse të siguruara siç janë: Memorandumi i Bashkëpunimit në mes të Shoqatës së Filozofeve të Kosovës (SHFK) dhe RTK-së nr.1065/15, Statutit të Shoqatës së Filozofeve të Kosovës (SHFK), Kontratën nr.3112/16, Formularin e deklaramentit të pasurisë 2016, si dhe duke u bazuar Ligjin nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, kemi ardhur në përfundim dhe mundë të themi se angazhimi z. Astrit Salihu, Këshilltar politik i Presidentit të Republikës së Kosovës, në cilësinë e autorit të emisionit, me karakter filozofik, kulturor dhe shkencor të emisionit “Filozofema” në Radio Televizionin e Kosovës, nuk mundë të cilësohet si situatë me Konfliktin të Interesit, apo mos pajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

